

**PROGRAMI
I TRAJNIMIT
FILLESTAR**

Programi i Trajnimit Fillestar

Në kuadër të mandatit ligjor Akademia e Drejtësisë zhvillon edhe aktivitete nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF), i cili fokusohet në zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të profesionistëve që hyjnë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial në cilësinë e gjyqtarit apo prokurorit të shtetit.

Në Akademinë e Drejtësisë, trajnimin fillestar janë duke e vijuar gjenerata e gjashtë e gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruar. Dekretimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit nuk ka qenë në periudhë të njëjtë prandaj PTF për prokurorët e shtetitka filluar në dhjetor të viti 2016, ndërsa për gjyqtarët e sapo emëruar ka filluar në fund të muajit shtator të viti 2017. Paraprakisht PTF për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të sapo emëruar i është nënshtruar procesit të miratimit nga Këshilli Drejtues i Akademisë.

Objektivë kryesore në kuadër të PTF-së, Akademia ka përcaktuar zhvillimin e kompetencave profesionale, personale dhe interdisiplinare si dhe zhvillimin e shkathtësive praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruar.

Programi i trajnimit fillestar zgjatë 12 muaj dhe është i strukturuar sipas modelit të kombinuar teorik dhe praktik. Pjesa teorike përfshinë trajnimin teorik i cili përmban përveç moduleve profesionale dhe karakterit inderdisiplinar edhe shqyrtime të rasteve nga praktika gjyqësore, simulime etj. Ndërsa pjesa e dytë, trajnimi praktik zhvillohet në gjykata/prokurorit përkatëse ku ata janë emëruar si dhe trajnime në institucione jo gjyqësore që lidhën me punën e gjyqtarit dhe prokurorit të shtetit.

Në fillim të janarit të vitit 2018, prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së gjashtë përmbushin trajnimin fillestar metrajnimin praktik në prokuroridhe me aktivitetin përmbyllës.

Duke qenë se Këshilli Prokurorial i Kosovës është në procesin e rekrutimit të prokurorëve të rinj, Akademia e Drejtësisë ka bërë përgatitjet paraprake për fillimin e trajnimit fillestar për prokurorët e shtetit të sapo emëruar të gjeneratës së shtatë. Ky program pritet të realizohet gjatë vitit 2018 bazuar në strukturën e moduleve trajnuese të përcaktuara nga Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë.

Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar do të vazhdoj në përmbushjen e programit teorik dhe praktik sipas plan programit dhe orarit të përcaktuar. Në kuadër të trajnimit teorik sipas programit deri në shtator 2018 do të realizohen dy ditë trajnimi në Akademi duke filluar nga moduli i Kodit të Procedurës Penale, Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar, E drejta Civile Administrative dhe Ekonomike, Shkathtësitë Personale dhe Interdisiplinare, Legjislacioni dhe Shkathtësitë plotësuese si dhe Mësimi në Distançë.

Trajnimi praktik do të vazhdojë të realizohet në gjykatat përkatëse ku ata janë të emëruar si dhe në institucionet jo gjyqësore sipas programit. Në përfundim të këtij programi do të realizohet vlerësimi përfundimtar në pajtim me Rregulloren e Trajnimit Fillestar.

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë të përcjellë zhvillimet në sistemin gjyqësor sa i përket procesit të rekrutimit të gjyqtarëve të rinj.